



PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen *Thaçi dhe të tjerë*, Trupi Gjykses mbajti një konferencë përgatitore për gjykimin më 18 janar, gjatë së cilës u diskutuan me palët aspekte të ndryshme të administrimit të procesit gjyqësor me qëllim përgatitjen e shpejtë të gjykimit.

Në fund të seancës, Trupi Gjykses informoi se synon që gjykimi të fillojë më 1 mars 2023. Gjykimi do të nisë me deklaratat hyrëse të ZPS-së dhe të mbrojtësit të viktimave. Ekipet e Mbrojtjes mund të vendosin që, nëse dëshirojnë, deklaratat hyrëse t'i bëjnë në fillim të gjykimit, ose pasi ZPS-ja të ketë përfunduar paraqitjen e provave.

Sot, pas konsultimeve të mëtejshme me palët dhe pjesëmarrësit, Trupi Gjykses ndryshoi urdhrin e tij të mëparshëm gojor dhe caktoi konferencën përgatitore të Prokurorit të Specializuar në çështjen Thaçi dhe të tjerët për 15 shkurt 2023, në orën 09:30.

Trupi Gjykses urdhëroi ZPS-në që në atë konferencë të paraqesë një vlerësim të rishikuar të sasisë së kohës që i duhet për paraqitjen e provave të saj, si dhe masat që ka marrë për ta shkurtuar kohën e paraqitjes së provave.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Trupi Gjykses, më 17 janar, me vendime të veçanta, urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Rexhep Selimi dhe të z. Jakup Krasniqi. Në kuadër të rishikimeve të përdymuajshme të paraburgimit, Trupi Gjykses konstatoi për të dy të akuzuarit se vazhdon të ekzistojë rreziku që ata mund të pengojnë procesin dhe/ose të kryejnë krime të tjera, dhe se ky rrezik mund të zvogëlohet mjaftueshëm nëpërmjet sistemit të mbikëqyrjes së komunikimeve në objektin e paraburgimit të DHSK-së.

Në çështjen gjyqësore të z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj, Paneli i Apelit njoftoi se do të shpallë aktgjykimin e apelit më 2 shkurt 2023, në orën 14:00. Seanca mund të përcillet në të tri gjuhët e gjykatës përmes transmetimit, me pak vonesë, në faqen e internetit të DHSK-së, ose nga galeria për publikun e DHSK-së. Kini parasysh se nevojitet regjistrim paraprak për përcjelljen e kësaj seance nga galeria për publikun. Më shumë informacion për këtë mund të gjeni në faqen e internetit të DHSK-së.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Paneli i Apelit, më 16 janar, rrëzoi një kërkesë të z. Haradinaj për një urdhër drejtuar ZPS-së për nxjerrjen e disa provave që Mbrojtja i konsideronte me rëndësi për hetimet e mëtejshme, të cilat Prokuroria thotë se nuk i disponon. Në vendim gjykatësit konstatuan se Mbrojtja nuk paraqiti ndonjë të dhënë që tregon se Prokuroria e kishte në zotërim atë material.





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative
N°2/2023
Hagë, 19/01/2023**

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

